



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRI

Numri i lëndës: 2022:227396

Datë: 05.02.2025

Numri i dokumentit: 06807148

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në lëndën penale kundër të pandehurit F.M. me numër të letërnjoftimit ... për shkak të veprës penale Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 320 par 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.298/2022, të datës 33.11.2022, si dhe bazuar në nenin 15 paragraf 1 të Ligjit nr.06/L-009 për Ndërmjetësim më datë 05.02.2025 mori këtë:

A K T V E N D I M

- 1. APROVOHET marrëveshja e arritur në procedurë të ndërmjetësimit** në lëndën **P.nr.405/2022** dhe me numër të marrëveshjes **ND: 24/2025**, e arritur me datën 05.02.2025 e pranuar nga gjyqtari me datë 05.02.2025, për të pandehurin e cekur si në pjesën hyrëse të këtij aktvendimi.
2. Marrëveshja e arritur në ndërmjetësim, e fiton fuqinë e vendimit të formës së prerë dhe dokumentit përmbarues sipas dispozitave ligjore në fuqi përfshirë këtu edhe dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbarimore.
3. Vendimi iu dorëzohet palëve dhe kundër të njëjtit, sikurse dhe kundër marrëveshjes së arritur, palët nuk kanë të drejtë ankese.
4. Prishjen apo anulimin e marrëveshjes së arritur në ndërmjetësim, palët kanë të drejtë ta kërkojnë vetëm me padi të veçantë gjyqësore.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRI –
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL
2022:227396, 05.02.2025**

**Gjyqtari
Agron Maxhuni**